

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË
ФАКУЛТЕТ ЗА БИЗНИС И ЕКОНОМИЈА
FACULTY OF BUSINESS AND ECONOMICS

STUDIME POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**“ANALIZA FINANCIARE E MENAXHIMIT TË
NDËRMARJES PUBLIKE KOMUNALE “TETOVA” PERIUDHA (2010-2018)**

KANDIDATI:
Bleran Ibraimi

MENTORI:
Prof.Dr. Rufi Osmani

Maj 2019,
Tetovë

Përmbajtja

1.	1. Hyrje	- 5 -
1.1	Përshkrimi i studimit	- 5 -
1.2	Qëllimi dhe rëndësia e studimit	- 5 -
1.3	Të dhënat e përdorura në studim	- 7 -
1.4	Organizimi i punimit	- 7 -
2.	2. Rishikimi i literaturës	- 8 -
2.1	Pikpamjet teorike për analizën e pasqyrave financiare	- 8 -
2.1.1	Qëllimi i analizës së pasqyrave financiare dhe përdoruesit e tyre	- 8 -
2.1.2	Përdoruesit e pasqyrave financiare	- 8 -
2.1.3	Objektivi i analizës së pasqyrave financiare	- 8 -
2.1.7	Analiza e mbrendshme dhe analiza e jashtme	- 9 -
2.1.9	Analiza statike dhe dinamike	- 9 -
3.	3. Analiza menaxheriale dhe struktura e ndërmarrjes komunale	- 11 -
3.1	Hierarkia menaxheriale e ndërmarrjes komunale	- 11 -
3.2	Funkcionet bazë të menaxhimit në ndërmarrjen komunale	- 12 -
3.2.1	NJ.P. SHËRBIMET E PËRBASHKËTA	- 13 -
3.2.2	NJ.P. HIGJIENA KOMUNALE	- 14 -
3.2.3	NJ.P. UJËSJELLËS DHE KANALIZIM	- 15 -
3.2.4	SHËRBIMI PËR REVIZION TË MBRENDSHËM	- 16 -
3.3	Analiza e mjedisit të mbrendshëm dhe të jashtëm të ndërmarrjes	- 17 -
3.3.1	Mjedisi i mbrendshëm	- 17 -
3.3.2	Mjedisi i jashtëm	- 21 -
3.3.3	SWOT analiza	- 23 -
4.	4. Analiza strukturore dhe dinamike e pasqyrave financiare	- 24 -
4.1	Analiza strukturore e raporteve financiare, vërejtjet e analizës	- 24 -
4.2	Analiza dinamike e raporteve financiare, vërejtjet e analizës	- 29 -
4.3	Bilanci Tatimor	- 33 -
4.4	Vërejtjet dhe rekomandimet nga analiza strukturore dhe dinamike e raporteve financiare	- 33 -
5.	5. Analiza e të hyrave dhe shpenzimeve të ndërmarrjes komunale	- 34 -
5.1	Analiza e të hyrave	- 34 -
5.2	Analiza specifike e të hyrave nga shitja e prodhimeve dhe shërbimeve	- 35 -
5.3	Analiza e trendit të të hyrave nga shitja e prodhimeve dhe shërbimeve për çdo sektor	- 36 -
5.4	Analizat e arkëtimit të të hyrave nga shitja për çdo sektor dhe rajon	- 37 -

5.5	Analiza dhe struktura e të hyrave të paarkëtuara	- 38 -
5.6	Analiza e shpenzimeve fikse dhe variabile	- 38 -
5.6.1	Sektori i ujësjellësit	- 39 -
5.6.2	Sektori i higjienës	- 40 -
5.6.3	Sektori i transportit.....	- 41 -
5.6.4	Sektori i kanalizimit.....	- 42 -
5.6.5	Sektori i shërbimeve të përbashkëta	- 43 -
5.6.6	Shpenzimet fikse dhe variabile në nivel të ndërmarrjes	- 44 -
5.7	Analiza e shpenzimeve të fuqisë punëtore.....	- 45 -
5.7.1	Rroga minimale, mesatare dhe maksimale e të punësuarve sipas sektorit	- 46 -
5.7.2	Rroga neto e udhëheqësve të ndërmarrjes.....	- 46 -
5.8	Analiza e trendit të shpenzimeve	- 47 -
5.8.1	Shpenzimet e energjisë.....	- 48 -
5.8.2	Shpenzime transporti	- 49 -
5.9	Humbja/ fitimi nga viti financiar	- 50 -
6.	6. Produktet/ shërbimet dhe analiza e çmimeve	- 51 -
6.1	Përshkrimi i produkteve dhe shërbimeve që ofron ndërmarrja.....	- 51 -
6.2	Përshkrimi i çmimeve të ndërmarrjes	- 52 -
6.3	Analiza e pikës kritike të rentabilitetit.....	- 54 -
7.	7. Analiza e fluksit të parasë (Cash Flow)	- 59 -
7.1	Analiza e fluksit të parasë - trendet.....	- 59 -
7.2	Analiza e koeficientëve financiar	- 60 -
8.	8. Investimet kapitale të NPK Tetova	- 63 -
9.	9. Diskutimi dhe analiza e të dhënave të gjetura	- 64 -
10.	10. Përfundimet dhe rekomandimet.....	- 66 -
11.	11. Bibliografia.....	- 68 -

Abstrakti

Qëllimi kryesor i kësaj teze magjistrature paraqet përdorimin efikas të metodave bashkëkohore për analizën e pasqyrave financiare si një mjet për marjen e vendimeve afatshkurte dhe afatgjate në menaxhimin e ndërmarrjes. Nënkuptohej se vendimet qualitative strategjike meren me të dhëna kualitative. Me diagnozë efikase mund të ndërmeret terapi efikase që do tu ndihmojë menaxherëve të kompanisë në përmbushjen e misionit dhe vizionit të kompanisë.

Në këtë tezë magjistrature objekt studimi do të jetë implementimi i tërësishëm i metodave bashkëkohore në analizën e pasqyrave financiare në ndërmarrjen “NPK Tetova- Tetovë”. Qëllimi i këtij studimi është që t’i sigurohen menaxhmentit të kësaj ndërmarrjeje informacione të rëndësishme, që t’i përdorin për përmirësimin e efikasitetit në menaxhimin e ndërmarrjes.

Analiza fundamentale e raporteve financiare do të bëhet me llogaritjen e treguesve analitik dhe vlerësimin se sa këta tregues analitik tregojnë anët e forta dhe të dobëta të menaxhimit të ndërmarrjes.

Studimi i kësaj problematike është bazuar në hipotezën kryesore se: “Performanca aktuale ekonomike dhe financiare e ndërmarrjes për veprimtari komunale “NPK Tetova” përkundër përmirësimit në vitet e fundit nuk janë optimiste për menaxhimin e suksesshëm të kompanisë” si dhe hipotezat ndihmëse që theksojnë se: “Pasqyrat financiare të ndërmarrjes vërtetojnë se kjo ndërmarrje ka defekte strukturore organizative dhe të menaxhimit financiar” dhe “gjendja në tre vitet e fundit të afarizmit të ndërmarrjes ka tendencë të përmirësimit të pjesërisht”.

Metodat kryesore të përdorurë në studimin e problemit janë: **metoda e analizës** si pjesë e hulumtimit që do të bazohet në pasqyrat financiare dhe dokumentet tjera financiare dhe menaxheriale dhe dokumente tjera të rëndësishme që do t’i shfrytëzoj për të qenë sa më efikas në analizimin e gjendjes së kësaj ndërmarrjeje, prej metodave të përgjithshme shkencore do të përdoret **metoda statistikore**, ku në mënyrë kuantitative do të jepen tabela dhe grafikone me të dhëna për gjendjen aktuale dhe gjendjen e 10 vitet e fundit të ndërmarrjes dhe **metoda komparative (krahasuese)**, ku do të shqyrtohet gjendja dhe menaxhimi i sektorëve të ndryshëm të ndërmarrjes.

Nëpërmjet këtyre metodave dhe të dhënave në dispozicion synohet vërtetimi i gjendjes faktike së ndërmarrjes dhe identifikimi i masave të nevojshme preventive duhet të ndërmiren për të përmirësuar gjendjen e ndërmarrjes.

1. Hyrje

1.1 Përshkrimi i studimit

Analiza e pasqyrave financiare është një proces gjykimi që synon të vlerësojë pozicionin financiar të kaluar dhe të tashmin në një firmë. Objektivi parësor i saj është përcaktimi, parashikimi dhe vlerësimi më i mirë i kushteve ekonomike dhe performacës në të ardhmen¹ (B.Ibraimi, 2019).

Në këtë punim do të bëhet analiza e karakteristikave kryesore financiare të ndërmarrjes për veprimtari komunale “NPK Tetova” duke analizuar efektet e çdo zëri bilancor në rezultatin final të ndërmarrjes, duke analizuar peshën e çdo zëri bilancor në bilancet ku përkasin këta zëra bilancor. Duke pasur parasysh peshën e kësaj ndërmarrjeje në qytetin e Tetovës dhe funksionet e kësaj ndërmarrjeje vendosa që të bëj një analizë financiare dhjetë vjeçare me qëllim për të pasqyruar mangësitë dhe mundësitë e kësaj ndërmarrjeje që të përballlet me sfidat e tregut bashkëkohor dhe teknologjitë bashkëkohore që na çojnë deri në produktivitet më të lartë në kryerjen e shërbimeve nga ana e kësaj ndërmarrjeje.

Si çdo analizë financiare e çdo ndërmarrjeje edhe kjo analizë e ndërmarrjes për veprimtari komunale “NPK Tetova”- Tetovë, përbëhet prej një tërësie mjetesh dhe metodash që na dërgojnë deri në vlerësimin e situatës financiare që është si rrjedhojë e punës disavjeçare e kësaj ndërmarrjeje. Gjatë këtij punimi do të bëj disa analiza financiare me anë të së cilëve do të nxjerrim konkluzione të ndryshme për punën disavjeçare të ndërmarrjes në fjalë dhe sfidat që e presin këtë ndërmarrje dhe aftësinë e saj për t’u përballur me sfidat e ndryshme që janë faktor të paevitueshëm që i tangojnë çdo ndërmarrje private ose publike. Disa nga analizat financiare që do t’i përdori në këtë punim janë:

- Analiza menaxheriale – do të përfshihet analiza e strukturës së ndërmarrjes, analiza e funksioneve bazë të menaxhimit, analiza e mjedisit të jashtëm dhe të mbrendshëm të ndërmarrjes, SWOT analiza si dhe analiza tjera të nevojshme për të nxjerrë konkluzione reale dhe sa më ekzakte.
- Analiza strukturore dhe dinamike të pasqyrave financiare – analiza e bilancit të gjendjes, analiza e bilancit të suksesit, analiza e listave përmbyllëse, analiza e trendeve të tyre.
- Analiza e shpenzimeve – analiza e shpenzimeve fikse, analiza e shpenzimeve variabile dhe analiza e shpenzimeve tjera të nevojshme në këtë tezë.
- Analiza e çmimeve – analiza e çmimeve, marzhës tregtare, analiza e pikës kritike të rentabilitetit.
- Analiza e informatave relevante.
- Analiza e fluksit të parave.

1.2 Qëllimi dhe rëndësia e studimit

Qëllimi kryesor i kësaj teze magjistrature paraqet përdorimin efikas të metodave bashkëkohore për analizën e pasqyrave financiare si një mjet për marjen e vendimeve afatshkurte dhe afatgjate në menaxhimin e ndërmarrjes. Nënkuptohej se vendimet kualitative strategjike

¹ Analiza financiare – Vjollca Karapinci, SHBLU (2002) . fq 9,

merren me të dhënat kualitative. Me diagnozë efikase mundet të ndërmeret terapi efikase që do tu ndihmojë menaxherëve të kompanisë në përmbushjen e misionit dhe vizionit të kompanisë.

Në këtë tezë magjistrature objekt studimi do të jetë implementimi i tërësishëm i metodave bashkëkohore për analizën e pasqyrave financiare në firmën “NPK Tetova”- Tetovë. Qëllimi i këtij studimi është që t’i sigurohen menaxhmentit të kësaj ndërmarrjeje informacione të rëndësishme, që ti përdorin për përmirësimin e efikasitetit në menaxhimin e ndërmarrjes.

Analiza fundamentale e raporteve financiare do të bëhet me llogaritjen e treguesëve analitik dhe vlerësimin se sa këta tregues analitik tregojnë anët e forta dhe të dobëta të menaxhimit të ndërmarrjes. Analiza e treguesëve financiar përfshin:

- Raportet e likuiditetit
- Raportet e aktivitetit
- Raportet e levës financiare
- Raportet e fitimit
- Treguesit e efikasitetit dhe treguesit e ngjajshëm
- Treguesit e sollventitetit dhe stabilitetit afatgjatë dhe afatshkurtë

Çelësi për marjen e informacioneve të rëndësishme nga analiza e treguesve dhe raporteve financiare është analiza e trendeve të këtyre treguesëve. Krahasimi mund të përfshin krahasimin e treguesëve në periudhë 10 vjeçare në kuadër të ndërmarrjes që të shihet se a punohet me efikasitet në ndërmarrje ose nuk punohet.

Përveç treguesit të lartpërmendur, objekt për analizë detale do të jenë edhe trendet e zërave të ndryshëm në bilancet e firmës, që janë të rëndësishme për marjen e menjëhershme të vendimeve për tu përmirësuar performanca e ndërmarrjes. Në këto analiza do të përfshihen edhe të hyrat dhe të dalurat e ndërmarrjes, do të përfshihet edhe analiza e çmimeve të prodhimeve dhe shërbimeve, caktimi i pikës kritike të rentabilitetit (Breakeven point) që si rrjedhojë e kësaj duhet gjithashtu të analizohen shpenzimet variable të ndërmarrjes, si dhe analiza e shumë treguesve tjerë financiar që do të na shërbejë për të nxjerrë konkluzione sa më të sakta për performancën e ndërmarrjes.

Duke pasur parasysh se performanca aktuale ekonomike dhe financiare e ndërmarrjes për veprimtari komunale “NPK Tetova” përkundër përmirësimit në vitet e fundit nuk janë optimiste për menaxhimin e suksesshëm të kompanisë, na shtyn që të analizojmë situatën se si ka ardhur deri në këtë gjendje kjo ndërmarrje dhe çfarë është bërë në përmirësimin e pjesërishëm të gjendjes në 3 vitet e fundit të kësaj ndërmarrjeje, ku janë pikat kryesore që është intervenuar dhe ka sjellë në përmirësimin e pjesërishëm të gjendjes financiare të ndërmarrjes në fjalë.

Një indikacion tjetër që na dërgon deri në konkluzione të ndryshme është edhe struktura organizative dhe menaxhmenti i kësaj ndërmarrjeje e cila ka defekte të ndryshme duke u bazuar në pasqyrat financiare të ndërmarrjes.

Me diagnostifikimin e mangësive kyçe të ndërmarrjes mun të nxjerrim konkluzione që kanë sjellë deri në këto mangësi si dhe hapat që duhet të ndërmeren që të mënjanohen këto mangësi me qëllim të funksionimit sa më efikas të ndërmarrjes dhe punimit të ndërmarrjes me efikasitet sa më të lartë.

1.3 Të dhënat e përdorura në studim

Çdo punim pa literaturë të mirëfilltë dhe burime dhënash nuk e ka cilësinë e duhur, prandaj jam munduar që për temën në fjalë të siguroj literaturë sa më cilësore që të bëj një analizë sa më reale dhe cilësore të ndërmarrjes për veprimtari komulac “NPK Tetova”. Të dhënat e përdorura në këtë tezë janë:

- **Literaturë profesionale:** Libra të ndryshëm shkencorë.
- **Publikime ligjore:** publikime ligjore që kanë të bëjnë me aktivitetin e ndërmarrjes
- **Të dhënat e kompanisë-** dokumente të ndryshme financiare dhe juridike

1.4 Organizimi i punimit

Në kreun e parë do të jepet një pamje e përgjithshme mbi studimin dhe disa veçori mbi studimin siç janë: qëllimi dhe rëndësia e punimit, të dhënat e përdorura në punim, metodat e përdorura gjatë studimit në mangësitë përkatëse, cilësinë e informacionit me të cilën do të punojmë etj.

Në kreun e dytë pëshkryhen dhe analizohen pikpamjet teorike të pasqyrave financiare. Veçoritë e pasqyrave financiare janë të dobishme për të treguar se si është gjendja e shoqërisë dhe ku janë anët e forta dhe të dobta të ndërmarrjes, ku janë mundësitë ku mund të ndërhyhet për tu përmirësuar ndërmarrja.

Gjithashtu do të bëhet edhe një përshkrim gjeneral i sektorit publik në Maqedoni, ku edhe vepron ndërmarrja “NPK Tetova”, karakteristikat e këtij sektori, mundësitë që na jep ky sektor në Maqedoni dhe kufizimet që na jep ky sektor. Gjithashtu do të bëhet edhe një përshkrim se si ndikojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në pasqyrat financiare dhe në fund do të përshkruhen edhe pikpamjet teorike mbi analizën menaxheriale.

Në kreun e tretë përshkruhet hierarkia menaxheriale e ndërmarrjes duke e ndarë në sektore të ndryshëm dhe udhëheqës të saj. Në vazhdim tregohen edhe detyrat bazë të çdo departamenti të saj. Në këtë kapitull është edhe SWOT analiza e ndërmarrjes duke vendosur theks të veçantë në: fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e ndërmarrjes. Një rëndësi të veçantë për ndërmarrjen gjithashtu janë edhe studimi i funrnitorëve, konsumatorëve të saj dhe forcës punëtore, struktura dhe vendndodhja e tyre. Si pjesë e analizës menaxheriale është bashkangjitur edhe analiza e mjedisit të jashtëm dhe të mbrendshëm.

Në kreun e katërt bëhet analiza horizontale dhe vertikale e bilancit të gjendjes dhe bilancit të suksesit duke parë trendet e lëvizjes së zërave bilancore dhe shkaqet e përmirësimit ose keqësimit të gjendjes së zërave bilancorë, gjithashtu theks të veçantë ka edhe dhënia e vërejtjeve dhe sygjerimeve për përmirësimin e gjendjes.

Në kreun e pestë bëhet analiza e të hyrave dhe të dalurave të ndërmarrjes në nivel të ndërmarrjes si dhe në nivel të sektorëve të ndërmarrjes. Në kapitullin e pestë gjithashtu bëhet edhe ndarja e shpenzimeve fikse dhe variable në nivel të ndërmarrjes dhe në nivel të sektorëve të ndërmarrjes dhe trendet e lëvizjes së tyre.

Në kreun e gjashtë përshkruhen çmimet e ndarjes, analiza e çmimeve të ndarjes dhe pika kritike e rentabilitetit për çdo sektor të ndërmarrjes.

Në kreun e shtatë janë llogaritur flukset e parasë (CASH FLOË) dhe treguesit financiar të ndërmarrjes.

Në kreun e tetë bëhet diskutimi dhe analiza e të dhënave të gjetura gjatë analizës së treguesëve financiar dhe ekonomik.

Në kreun e nëntë jepen rekomandimet dhe konkluzionet për ndërmarrjen.

Në kreun e dhjetë jepen librat, materialet dhe dokumentet që janë përdorur për analizën e ndërmarrjes.

2. Rishikimi i literaturës

2.1 Pikpamjet teorike për analizën e pasqyrave financiare

2.1.1 Qëllimi i analizës së pasqyrave financiare dhe përdoruesit e tyre²(B.Ibraimi, 2019)

Analiza e pasqyrave financiare zbaton mjete, teknika analitike dhe metoda të nevojshme për analizën e biznesit. Është një mjet diagnostifikimi për vlerësimin e aktiviteteve të financimit, investimit dhe operative dhe gjithashtu është një mjet vlerësimi për vendimet e drejtimit dhe vendime të tjera të biznesit. Objekti i APF është: të informojë të interesuarit mbi njësinë ekonomike dhe rezultatet e saj.

2.1.2 Përdoruesit e pasqyrave financiare

Përdoruesit e pasqyrave financiare janë:

- Investitorët dhe kreditorët e kapitalit.
- Qeveria, agjencitë qeveritare dhe autoritetet tatimore.
- Publiku në përgjithësi dhe grupe të veçanta interesi, sindikata dhe grupe konsumatorësh

2.1.3 Objektivi i analizës së pasqyrave financiare³

Para se të fillojmë analizën e pasqyrave financiare të një shoqërie është e nevojshme të specifikohen objektivat e analizës. Objektivat do të jenë të ndryshme sipas qëllimeve të përdoruesit dhe pyetjeve që kërkohen tu jepet përgjigja nga analiza e të dhënave të pasqyrave financiare. Objektivi i analizës financiare është matja e krahasuar e riskut dhe kthimit në marjen e vendimeve të investimit apo të kreditimit.

² http://www.ikub.al/SHKOLLA_CATEGORY/911250031/Article-ANALIZA-PASQYRAVE-FINANCIARE.aspx,

³ Analiza e pasqyrave financiare – Halit Xhafa, 2008, fq 207

2.1.7 Analiza e mbrendshme dhe analiza e jashtme

Karakteristikat e analizave ndryshojnë në mënyrë thelbësore në varësi të faktit nëse janë bërë nga një analist i mbrendshëm apo nga një analist që është jashta firmës.

Analisti i jashtëm mund t'i barazojë punimet e tij vetëm nga të dhënat e tij nga bilanci i destinuar për publikim, pra mbi gjendjen e pronësisë, mbi llogaritë ekonomike dhe mbi të thënat e administratorëve. Të dhënat e tilla janë normalisht të pamjaftueshme për të analizuar një analizë të plotë mbi firmën, d.m.th mbi strukturat e saja.

Analisti i mbrendshëm, në të kundërt, ka në dispozicion, përveç të dhënave të bilancit, një sasi informacioni që ndihmon të shprehë një gjykim shumë më të besueshëm. Analisti i mbrendshëm ka në fakt liri-hyrje tek të dhënat mbi strukturën organizative, tek të dhënat e kontabilitetit analitik, tek ato të planifikimit organizativ (plane afatmesëm dhe afatgjatë, buxheti i periudhës dhe ndarjet e tij në nënperiudha). Përveç kësaj analisti i mbrendshëm mund të njohë informacione të tjera, veçanërisht të dobishme për studime të tilla si: kategoritë e portoflit të firmës dhe mbi të gjitha, të dhëna mbi dinamikën e operacioneve të firmës, dinamika e shitjeve dhe e blerjeve, dinamika e arkëtimeve dhe pagesave, të dhënat mbi paftësinë paguese etj.

Në kategorinë e fundit futen edhe ata që, megjithëse të huaj në firmën, kanë liri-hyrje tek të njëjtat informacione jashtë bilancit dhe që janë të disponueshme për analistët e jashtëm. Bëhet fjalë për konsulente, banka ose furnitorë, të cilët kanë aftësinë kontaktuese për të imponuar vënien në dispozicion të të gjitha të dhënave të nevojshme për analizën dhe administratën fiskale, e cila mund t'j marrë në mënyrë të detyrueshme.

Si përfundim mund të themi se analiza e jashtme zhvillohet vetëm mbi bazën e të dhënave të bilancit, kurse ajo e mbrendshmeja i referohet informacioneve shtesë.

2.1.9 Analiza statike dhe dinamike⁴

Analizat statike, të quajtura edhe strukturore ose hapsinore, prirën të evidentojnë rezultatet e një bashkësie operacionesh të raportuara në një çast të caktuar. Bëhen normalisht duke marrë në shqyrtim bilancine e një firme os firmave të ngjajshme.

Analiza e të dhënave vetëm të një bilanci të një firme (analiza statike në kuptim të ngushtë) është përcaktuar si analizë strukturore, ose e çastit, ose vertikale, sepse tregon përbërjen e zërave të ndryshëm të kapitalit ose të të ardhurave, me qëllim që të nxjerë vlerësime mbi strukturën ekonomike financiare ose pronësore të firmës.

Analiza strukturore kufizohet vetëm me thënien e asaj që firma është në këtë moment. Bëhet fjalë për një studim me nivel të ulët sepse nuk bazohet në krahasime. Analizat e strukturës ekonomike prirën të pasqyrojnë përbërjen korrekte të llojeve të ndryshme të shpenzimeve dhe të të ardhurave.

⁴ Analiza financiare – Vjollca Karapinci, 2002, fq 16 ,

Ato që i referohen strukturës financiare kërkojnë të tregojnë përbërjen e burimeve të financimit dhe të evidentimit të sistemit të pronësisë të aktiveve dhe pasiveve. E gjithë kjo është raportuar për një periudhë të caktuar.

Analiza statike që u referohet dy ose më shumë firmave është përcaktuar si “hapësinore”. Ajo mund të lejojë krahasimet mes firmave pro dhe presupozon që:

Firmat të dhënat e të cilave krahasohen duhet të operojnë jo vetëm në të njëjtin sektor, por edhe në kushte strukturore, organizative, produktive dhe drejtime të ngjajshme, gjë që nuk ndosh shpesh. Si rrjedhim i rezultateve të arritura duhet t’u jepet një kuptim shumë relativ;

Firmat duhet të aplikojnë kritere të njëjta për kontabilizimin, paraqitjen dhe vlerësimin e pronësisë dhe të të ardhurave. Edhe ky kusht verifikohet nëse egzistojnë skema të detyrueshme të bilancit;

Nuk duhet të kenë ndërhyrje procese inflacioniste, ligje që u lejojnë shumë hapësirë veprimi hartuesëve të bilanceve ose operacioneve të jashtëzakonshme në firmat që krahasohen (shkrirje, ndryshime strukturore etj), sepse kjo do të thoshte që të krahasonim të dhëna johomogjene dhe si rrjedhim të arrinim në rezultate që kanë vlerë ose janë të gabuara;

Analiza hapësinore mund të zhvillohet edhe duke i u referuar të dhënave standard të sektorit.

Përveç kritikave të posapërmendura për krahasimet ndërorganizative, të cilat vihen në dukje edhe vështirësia për të gjetur të dhëna të sektorit që t’i krahasojmë me rezultatet e analizës vertikale të bërë me bilancin e firmës së interesuar.

Analizat dinamike quhen edhe të vazhdimësisë , të tendencës, të aspektit kohorë, serial ose horizontal. Ato kanë qëllim të tregojnë variacionet e një strukture të dhëne vlerash në kohë. Ato kërkojnë disponimin e një vargu bilancesh të së njëjtës firme që studiohet.

Këto analiza konsistojnë në evidentimin e tendencave të burimeve të drejtimit, ose të aspekteve të tyre të veçanta në kohë. Për këtë arsye përcaktohen si analiza të tendencave ose të trendit. Ato lejojnë qartësimin e evolucionit në kohë të elementeve më të rëndësishme të gjykimit mbi firmën. E thënë ndryshe, soliditetin pronësor, ekuilibrin financiar e monetar, të ardhurat, aftësinë e vetëfinancimit, eficiencën e firmës, etj.

Për të mundur të bëjmë një analizë seriale të një firme të caktuar duhet para së gjithash të egzistojnë kushtet e mëposhtme:

Nuk duhet të ndërhyjnë ndryshime radikale në drejtimin e ndërmarrjes me efekt ndarjen, shkrirjen, braktisjen e prodhimeve, hapjen e tregjeve të reja, etj. Në këtë rast të dhënat duhet të përshtaten përpara se të procedojmë me analizën e tendencave,

Nuk duhet të shfaqet në mënyrë të ndjeshme fenomeni i rënies së vlerës së monedhës. Në rast të kundërt, përpara se të bëjmë krahasimet, të dhënat duhen homogjenizuar, duke shfrytëzuar kontabilitetin përkatës për inflacion;

Nuk duhet të kenë ndërhyrje faktorët të jashtëzakonshëm që të kenë ndikuar në mënyrë të ndjeshme mbi një ose më shumë veprime. Krahasimet bëhen mbi të dhënat e drejtimit të zakonshëm, duke eliminuar të gjitha rezultatet e operacioneve.

3. Analiza menaxheriale dhe struktura e ndërmarrjes komunale

3.1 Hierarkia menaxheriale e ndërmarrjes komunale

Ndërmarrja për veprimtari komunale “NPK Tetova” ka një strukturë të përbërë menaxheriale që është e përbërë prej drejtorit gjeneral, udhëheqësve teknik për kanalizim, higjienë komunale dhe shërbimeve të përbashkëta. Çdo sektor i kësaj ndërmarrjeje gjithashtu ka edhe udhëheqësit e nënsektorëve të ndryshëm që e kompletojnë hierarkinë menaxheriale të kësaj ndërmarrjeje. Në mënyrë grafike hierarkia menaxheriale⁵ (B.Ibraimi, 2019) e kësaj ndërmarrjeje do të ishte:




Tabela 4 – Kierarkia menaxheriale e ndërmarrjes

⁵ <https://www.npktetova.mk/struktura-organizative/>

Hierarkia menaxheriale e ndërmarrjes në fjalë është e ndarë në tre pjesë. Në krye të kësaj hierarkie është drejtori general dhe pastaj vijnë një nivel më poshtë udhëheqësit teknik të sektorëve të ndryshëm edhe atë: sektori i shërbimeve të mbrendshme, sektori higjienës komunale dhe sektori i kanalizimit dhe ujësjellësit.

3.2 Funkcionet bazë të menaxhimit në ndërmarrjen komunale

Ndërmarrja është një subjekt ekonomik që përbëhet nga disa sektorë që menaxhohet nga menaxherët për të arritur efikasitet sa më të lartë në punë. Si çdo ndërmarrje edhe ndërmarrja për veprimtari komunale është e organizuar në sektorë të ndryshëm që menaxhohen nga menaxherët e saj që janë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të prodhimit dhe shërbimeve që i ofron kjo ndërmarrje.

Vendet e punës përcaktohen sipas llojit, gjinisë dhe lidhshmërisë së obligimeve në punë. Emërtimi i vendeve të caktuara të punës përcaktohet në bazë të sasisë, rëndësisë dhe kompleksitetit të obligimeve të vendit të punës në përputhje me dispozitat pozitive ligjore. Secila punë për vendin e caktuar të punës ka emërtimin e vet.

Emërtimi i vendit të punës përcaktohet sipas llojit të punës.

Sipas parimit organizativ “NPK Tetova” – Tetovë veprimpatrinë e saj e ushtron nëpërmjet: Njësive punuese me Seksione dhe Shërbime, edhe atë:

1. NJ.P. Shërbimet e përbashkëta
2. Nj.P. Higjiena Komunale
3. NJ.P. Ujësjellësi dhe kanalizimi
4. Shërbimi për revizion të mbrendshëm

NJ.P. “Shërbimet e Përbashkëta” është organizuar në 4 (katër) shërbime:

- 1.1 Shërbimi për punë juridike dhe të përgjithshme
- 1.2 Shërbimi kontabël dhe për financa
- 1.3 Shërbimi për furnizim dhe komercializëm
- 1.4 Shërbimi për punë teknike zhvillimore dhe investuese

NJ.P. “Higjiena Komunale” janë të organizuara në 7 (shtatë) seksione:

- 2.1 Seksioni për higjienë individuale komunale
- 2.2 Seksioni për higjienë publike komunale
- 2.3 Seksione për parqe, gjelbërim dhe terene sportive
- 2.4 Seksioni për mirëmbajtje të deponive
- 2.5 Seksioni për vareza
- 2.6 Seksioni i automekanikës dhe merimanga
- 2.7 Seksioni për kafshë endacak

NJ.P. “Ujësjellësi dhe Kanalizimi” është organizuar në 3 (tre) seksione:

- 3.1 Seksioni për ujësjellës
- 3.2 Seksioni për kanalizim
- 3.3 Seksioni për punë ndëtimore

SHËRBIMI PËR REVIZION TË MBRENDSHËM

Shërbimi për revizion të mbrendshëm funksionon si shërbim i veçantë dhe i pavarur në kuadër të ndërmarrjes.

3.2.1 NJ.P. SHËRBIMET E PËRBASHKËTA

Veprimtaria bazë e NJP “Shërbimet e përbashkëta” është ushtrmi i të gjitha aktiviteteve me interes të përbashkët të ndërmarrjes lidhur me aspektet financiare, komerciale, administrative dhe juridike të punës dhe sigurimit të pronës së ndërmarrjes.

Nga aspekti i fushëveprimit të punës së seksioneve, seksionet kryejnë punët në vijim, edhe atë: Shërbimi për punë juridike dhe të përgjithshme:

Veprimtaria bazë e shërbimit për punë juridike dhe të përgjithshme si pjesë përbërëse e NJP “Shërbime të përgjithshme”, është kryerja e punëve nga lëmia e marrëdhënieve të punës, përfaqësime dhe padi, përmbarime të aktvendimeve profesionale dhe teknike, jep ndihmë profesionale dhe bashkëpunon me shërbimet adekuate gjatë punësimit të kadrove të rinjë në ndërmarrje, mer pjesë në përpilimin e akteve të ndërmarrjes publike.

Përpilon aktvendime për pranim, paraqitje të punëtorëve dhe ndërprerje të marrëdhënieve të punës, përpilon aktvendime për sistemimin e punëtorëve, aktvendime për pushime me dhe pa pagesë, pushime vjetore, shpall nevojën për punëtor, mban evidencë të përhershme të të punësuarëve në ndërmarrje, hap dosje, jep të dhëna të shërbimit në Komunë, bën kontrollimin e pushimeve mjekësore.

Shërbimi kontabël dhe për financa:

- Ushtron mbikqyrje dhe e këshillon udhëheqësinë për kontrollë mbi buxhetin (përgaditje dhe realizim), kontrollë financiare, kontrollë për realizim të politikave të përcaktuara dhe administrim operativ (mbikqyrje mbi procesin e gjithmbarshëm të administrimit dhe kontrollë), kontabilitetin dhe referimin financiar.

- Kordinon procesin e përgaditjes, ndryshimit dhe plotësimit të buxhetit si dhe planit strategjik të ndërmarrjes, procesin e zhvillimit, vendosjes, zbatimit dhe mirëmbajtjes së administrimit financiar dhe procesin e kontrollës, procesin e evidencës kontabël dhe përgaditjen e llogarisë vjetore si dhe raportin financiar vjetor. Në mënyrë obligative jep mendim për propozim aktet që i përpilojnë njësitë tjera organizative në ndërmarrje dhe subjektet tjera të cilët kanë ose mund të kenë implikime financiare për buxhetin e ndërmarrjes;

- Zbaton mbrojtjen e mjeteve dhe obligimeve vlera e të cilave është evidentuar në gjendjen e bilancit. Përpilon plan për vendosjen e kontrollës dhe administrimit financiar si dhe metodologji për realizim të planit; Ndjekje dhe zbatim të rregullativës ligjore nga fusha e kontabilitetit, punës materialo- financiare; Ndjekja e përditshme e punëve arkëtues;

- Përlllogaritje dhe pagesë të rrogave të të punësuarëve; Përgaditje të llogarisë përfundimtare dhe raporteve periodike financiare; Përgaditje të raporteve themelore financiare (bilanci i gjendjes, bilanci i të hyrave dhe të dalurave, bilanci i konsoliduarë i pronës kapitale, bilancin e ngarkimeve i dhe shërbimeve/ arsyetime në shtojcë të raporteve financiare). Evidentimi kontabël i obligimeve dhe mjeteve themelore të arritura; Pagesa sipas dokumentacionit kontabël.

- Përgaditje të raportit për mjete të planifikuar dhe të harxhuara në bazë të nivelit (Pasqyra tabelare krahasimore)

SHËRBIMI PËR FURNIZIME DHE KOMERCIALIZËM

Ndjekje dhe zbatim të rregullativës ligjore nga lëmia e furnizimeve publike, instrukcione dhe këshilla komisionit për furnizime publike. Përgaditje të procedurave interne për furnizime publike; Ndjekje dhe parashikim të nevojave për furnizime publike në ndërmarrje; Përgaditje të planit vjetor për furnizime publike dhe realizim të planit; Përgaditje të aktvendimeve, marëveshjeve për furnizime publike; Përgaditja e shpalljeve për furnizime publike dhe dokumentacionit tenderik;

Kontrollon rregullshmërinë e faturave të dërguar në bazë të kontratave të lidhura për furnizime dhe harmonizimin e tyre me fletëpagesat/ urdhëresat e punës dhe porositë; Mbajtje të evidencës së furnizimeve publike që kryen sipas llojit të procedurave dhe evidentimi i llojeve të tjera të furnizimeve; Përgaditje të kontratave për furnizime publike dhe ndjekje të realizimit të tyre;

Kontrollim të urdhëresave për porosi deri te furnizuesit përkatës konform kontratave të lidhura për furnizime dhe ndjekje të realizimit të porosive; Analizon nevojën për materialet e harxhuara dhe pajisjeve si dhe përgadit projekt plan për furnizim për vitin e ardhshëm; Përgadit pëlqime për furnizime të vogla dhe e ndjek realizimin e tyre; Mban evidencë dhe bën pranimin e të gjitha faturave hyrëse; Udhëheq evidencë për pagesë të kërkesave të arritura nga furnizuesit; Përgadit urdhëresa për pagesë – virmane, i dërgon në bankë për pagim me autorizim të drejtorit; Bën pranimin e marëveshjeve për kompenzim, cesion, asignacion dhe veprim sipas të njëjtave;

SHËRBIMI PËR PUNË TEKNIKE ZHVILLIMORE DHE INVESTUESE

Veprimtaria themelore e shërbimit për punë teknike, zhvillimore dhe investuese si pjesë përbërëse e Shërbimeve të përbashkëta është pjesëmarrja në përpunimin e analizave nga puna dhe përpunimi i strategjisë zhvillimore të ndërmarrjes në domenin e veprimtarive që i kryen me aplikim dhe realizim të projekteve prioritare, merr pjesë në realizimin e programeve zhvillimore të të gjitha njësive punuese që egzistojnë dhe funksionojnë në kuadër të ndërmarrjes komunale publike "NPK Tetova" Tetovë.

3.2.2 NJ.P. HIGJIENA KOMUNALE

NJP "Higjiena Komunale" përkujdeset për mbledhjen e mbeturinave në kohë dhe në mënyrë kualitative si dhe fshirje dhe larjen, transportimin dhe deponimin e mbeturinave nga amvisëritë dhe ndërmarrjet si dhe personave të tjerë juridik. Sipas fushëveprimit të punës të seksioneve, seksionet i kryejnë edhe punët në vijim:

Seksioni për higjienë komunale individuale

Rregulisht bart dhe transporton mbeturina komunale, grumbullon dhe bart mbeturina nga amvisëritë, ndërmarrjet dhe entet deri në deponi.

Seksioni për higjienë publike komunale

Mirëmbajtja e pastërtisë publike në qytet, fshirja dhe larja e sipërfaqeve publike dhe hapësirave të hapura të objekteve publike, pastrimi i borë në kushtet e dimrit hudhja e kripës gjatë dimrit, grumbullimi i mbeturinave nga mbajtja dhe vendosja në kanta për mbeturina, mirëmbajtja e rregullt dhe pastrimi i gjelbërimit në qytet, nxjerja manuale dhe me maqinë e rrënjëve, lëvrimit vjeshtor si dhe mbjellja e fidaneve të reja.

Seksioni për parqe, gjelbërim dhe terene sportive

Mirëmbajtja e rregullt e gjelbërimit në qytet, patrimi kontinual i zonave të gjelbërta, nxjerja e rrënjëve në mënyrë manuale dhe me maqina, lëvrimit vjeshtor si dhe pastrimi manual, mbjellja e fidaneve të reja ndërtimi i hapësirave të reja dhe parqeve si dhe punë të tjera nga domeni i seksionit.

Seksioni për mirëmbajtjen e deponive

Transportim dhe deponim të mbeturinave deri në deponi.

Mirëmbajtje të deponisë dhe punë të tjera nga domeni i seksionit.

Seksioni i varezave ortodokse

Mirëmbajtje dhe rregullimin e varezave ortodokse; Sigurim të vendit adekuat për mbajtje të mbeturinave dhe mbetjeve të tjera, mban evidencë të të vdekurve; Jep vendvarrim për varrim të kufomave; Përgadit fundamente sipas nevojave; Varrim të kufomave.

Seksioni i automekanikës dhe merimangës

Përgadit automjetet për punën rrjedhëse për transport të mbeturinave komunale; Transportim të materialeve ndërtimore, tokë dhe të tjera për nevojat e NJP gjatë realizimit të punëve ndërtimore si dhe gropimin e tokës dhe planifikim dhe mbulim të tyre me maqina ndërtimore; Përgadit automjetet për punë në kushte dimërore; Mirëmbajtje teknike të parkut vozitës dhe të maqinave;

Kontrollim të rregullt të rregullshmërisë së mjeteve dhe maqinave ndërtimore, kotrolla teknike, regjistrim dhe servisim; Punë bravarie dhe zejtarie. Mban evidencë për punët e kryera gjegjësisht për urdhëresat e punës; Mban dokumentacion për pjesët e montuara, karburante dhe vajëra të harxhuara si dhe të kilometrave të kaluara; Mban evidencë për orët efektive në punë.

Shërbimi për kafshët endacak

Bëhet ndjekja dhe kapja e kafshëve endacak dhe transportohen deri në stacionar dhe bëhet çranimi i tyre ku menjëherë bëhet edhe kontrolli i tyre si dhe dezinfektimi, mbahet evidencë për çdo kafshë të pranuar dhe bëhet ovariohisterotomia dhe orgiektomia bëhet rikuperim postoperativ dhe te të gjitha kafshët pastrehë të kapura bëhet vaksinim dhe dehëllmintizim dhe më pas bëhet transporti i tyre deri në vendet që janë kapur kurse në kafshët me gjendje të rëndë shëndetësore si dhe kafshët e rrezikshme bëhet autanizimi i tyre.

3.2.3 NJ.P. UJËSJELLËS DHE KANALIZIM

Sipas fushëveprimit të NJ.P. "Ujësjellës dhe kanalizim" seksionet në kuadër të NJP i kryejnë punët në vijim, edhe atë:

SEKSIONI I UJËSJELLËSIT

Sigurim të ujit për pije në teritorin e komunës; Kontrollë sistematike të rrjetit; Mirëmbajtje e rregullt vijuese; Mirëmbajtje sistematike e sistemit për furnizim me ujë; Ndërim të ujëmatësve; Krijim e kyqje për nevojat e qytetarëve dhe ekonomive;

Kryen mënjanimin e të gjitha defekteve në sistemin për furnizim me ujë; Kujdeset për rregullshmërinë e rrjetit të ujit nga kaptazha deri te rezervuari dhe rrjeti; rriparon defektet e rrjetit të përcjella me armatura, ventila lëshuese, puseta dhe fontanave publike; Në mënyrë sistematike ndjek shtypjet e rrjetit; Mirëmban, monton dhe çmonton ujëmatësit.

SEKSIONI I KANALIZIMIT

Dërgimi dhe pastrimi i ujërave atmosferike dhe fekale; Kontrollë sistematike e rrjetit dhe mirëmbajtje të rregullt; Mbajtje në gjendje të rregullt të rrjetit atmosferik dhe fekal si dhe objekteve përcjellëse në të, puseta reviduese, lëshimeve, mbushjeve, sifonave etj. Intervenon me cisterna me presion, vakum, dhe intervenime me mjete dore, çekrek, sajlla dhe të ndryshme; Realizon kyqje në kanalizim dhe kryen kontrollim të të njëjtave si dhe rikonstruime. Mirëmban pusetat e mëdha të pompat e stacioneve fekale.

SEKSIONI PËR PUNË NDËRTIMORE DHE SINJALIZIM RRUGOR

Seksioni i kryen të gjitha punët ndërtimore për ndërtim të objekteve me karakter infrastrukturorë për veprimtaritë komunale të cilat i kryen ndërmarrja; Për këta qëllime në kuadër të seksionit ndërmerren të gjitha pënët ndërtimore si murratim, ngjyrosje dhe suvatim si dhe punë të tjera sipas nevojës; Në kuadër të seksionit kryen edhe aktivitete që kanë të bëjnë me sinjalizimin e rrugëve si për sinjalizimin vertikal ashtu edhe për atë horizontal.

3.2.4 SHËRBIMI PËR REVIZION TË MBRENDSHËM

Funksionon si shërbim i veçantë dhe i pavarur në kuadër të ndërmarrjes dhe i kryen punët si në vijim: Në bazë të vlerësimit të rrezikut përpilon plan vjetor për revizion të mbrendshëm dhe e ndjek dhe siguron zbatimin e tij; Përgadit raport vjetor për punën e revizionot të mbrendshëm.

Raportin e revizionit e dorëzon te drejtori; Ndjek dispozitat, standardet dhe udhëzimet që janë me rëndësi për revizionin e mbrendshëm dhe përkujdeste për realizimin kualitativ të revizionit të mbrendshëm; Miraton programin për çdo revizion ndaras; E përpilon dhe e realizon programën në veçanti për çdo revizion, Vlerëson kompaktibilitetin e punës së subjektit me ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e mbrendshme të cilat janë në fuqi; E vlerëson funksionimin e sistemeve për administratim financiar dhe kontrollë të ndërmarrjes;

Kontrollon saktësinë dhe kompletimin e evidencës kontabël dhe raportet financiare të ndërmarrjes; Kontrollon ekonomicitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e punës dhe shfrytëzimin e mjeteve në fushë të definuar të aktiviteteve dhe programeve; Ndjek realizimin e masave të ndërmarra nga udhëheqësit e njësive organizative të reviduara në bazë të rekomandimeve të raporteve të revizionit;

Mban dosje për revizion të mbrendshëm në të cilat ruhen të gjitha dokumentet e punës; Informon për konflikt interesesh lidhur me revizionin dhe nëse gjatë revizionit paraqitet dyshimi për parregullësi ose mashtrim që mund të rezultojë me përgjegjësi penale kundërvajtëse ose disiplinore.

SISTEMIMI DHE PËRSHKRIMI I VENDEVE TË PUNËS

Në këtë rregullore janë përcaktuar dhe përshkruar vendet e punës të sistemuara sipas njësive organizative konform organizimit të mbrendshëm të “NPK Tetova” Tetovë.

Struktura e menaxhimit të kësaj ndërmarrjeje është e përbërë nga:

- DREJTORI GJENERAL - Drejtori i ndërmarrjes organizon punën dhe udhëheq me ndërmarrjen, e përfaqëson ndërmarrjes si dhe është përgjegjës për ligshmërinë gjatë punës në ndërmarrje, drejtori porpozon politikë afariste dhe merr masa për realizim, përgjigjet dhe paraqitet për mbrojtje, organizon realizimin e vendimeve dhe konkluzave të sjellura me deklaram personal të punëtorëve dhe vendimeve të këshillit drejtues, e përfaqëson, nënshkruan dhe lidh kontrata në emër dhe për llogari të ndërmarrjes. Drejtori i kryen të gjitha punët konform Ligjit dhe Statutit të ndërmarrjes.
- UDHËHEQËSI TEKNIK – është përgjegjës para drejtorit dhe ka këto përgjegjësi:
 - Pranon detyra për punë të shërbimit nga drejtori i NPK;
 - Udhëheq me punën e shërbimit;
 - I nënshkruan aktet që i përpilon për nevojat e shërbimit
 - Çdo ditë e shqyrton postën e pranuar dhe të njëjtën në kohë të duhur e drejton nëpër ekzekutues;]
 - Rregullisht kontakton me udhëheqësit e njësive punuese “Higjiena komunale”, “Ujësjellës dhe kanalizim” dhe drejtorin e NPK-së;
 - Merr pjesë gjatë marrëveshjes për marrjen e punëve, përpilimin e çmimeve për shërbime, lidhjen e kontratave dhe të ngjajshme.
 - Kryen edhe punë të tjera me urdhër të drejtorit të NPK;

UDHËHEQËSI – është përgjegjës para drejtorit, bënë udhëheqjen e veprimtarisë së përgjithëshme të ndermarrjes, merr pjesë në mbledhje, kolegjiume dhe seanca të këshillit drejtues sipas nevojës; E planifikon, organizon dhe kontrollon punën të shërbimit; Jep udhëzime dhe urdhëra për kryerje të detyrave punuese; I analizon dhe vlerëson rezultatet e punës; Sipas nevojës dhe me autorizim e përfaqëson ndermarrjen para gjykatave kompetente;

Ndjek rregullat ligjore dhe jep mendim dhe interpretim të duhur; Zhvillon dhe propozon masa për përparimin e disiplinës; Punon në përgaditjen, përpilimin dhe sjelljen e akteve të përgjithëshme; E organizon punën e gjithëmbarshme arkivore; Organizon përkthimin e materialeve; E organizon shtypjen e të gjitha materialeve për nevojat e ndermarrjes; E organizon punën e mensës, rrojtareve, higjienistëve, mjeshtërve të shtëpisë, korierit;

SHEF I KONTABILITETIT – Udhëheqësit e Shërbimit Ekonomik të Kontabilitetit (SHEK), pranon detyra nga udhëheqësi i SHEK;

Kujdeset për kryerjen e drejtë të të gjitha operacioneve kontabile të NPK; Është përgjegjës për hartimin me kohë të llogarive periodike dhe përfundimtare dhe të njëjtat t'i dorëzojë në kohë në organet e NPK për shqyrtim; Rregullisht i ndjek dispozitat nga lëmia e kontabilitetit dhe punës financiare; Propozon vendime dhe aktvendime të cilat duhet të sillen nga ana e organeve drejtuese; Kontrollon të punuarit e kontabilistëve dhe u jep udhëzime për kryerjen e drejtë të detyrave punuese;

Kryen edhe punë të tjera nga lëmia e kontabilitetit dhe punës financiare me urdhër të udhëheqësit.

3.3 Analiza e mjedisit të mbrendshëm dhe të jashtëm të ndermarrjes

3.3.1 Mjedisi i mbrendshëm

Konsumatorët

Analiza e mjedisit të mbrendshëm të organizatës ka për qëllim studimin e të gjithë faktorëve që veprojnë që veprojnë brenda një organizate me qëllim përcaktimin e dobësive dhe fuqive të saj.

Ndërmarrja publike komunale “NPK Tetova” – Tetovë është themeluar në vitin 1989, që në fillim të veprimtarisë së saj kjo ndermarrje ka ofruar shërbime për ujë të pijshëm, kanalizime, mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave, mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta – parqeve dhe tereneve sportive, pastrimin e rrugëve. Në ndermarrje janë të punësuar 408 punonjës, ndërsa të regjistruar janë 359.

Ndërmarrja publike ka cilësinë e personit juridik. Cilësinë e personit juridik e fiton në ditën e regjistrimit në regjistrin e gjykatës. Emri i plotë i ndermarrjes është “Ndërmarrja Publike Komunale Tetova”-Tetovë me përgjegjësi të plotë Tetovë. Emri i shkurtuar i ndermarrjes është “NPK Tetova” P.P. Tetovë. Selia e ndermarrjes publike është në Tetovë në rr. 120 nn. Ndërmarrja ka vulën e vet, vulën katrore dhe amblemën. Ndërmarrja ka amblemën e vet me të cilën theksohet veprimtaria e ndermarrjes.

Analiza e mbrendshme e kësaj organizate do të fokusohet në tre faktorë kyq që përcaktojnë funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kësaj organizate. Këto faktorë janë mjaft determinues në mbarëvajtjen e procesit të shërbimeve dhe janë shumë të rëndësishëm për funksionimin e kësaj organizate.

Furnitorët


Ndërmarrja prej themelimit të saj në vitin 1989 ka bashkëpunuar me një numër shumë të madh furnitorësh të profileve dhe prej vendeve të ndryshme. Gjatë historisë së saj 30 vjeçare ajo ka bashkëpunuar me 256 ndermarrje që e kanë furnizuar me produkte dhe shërbime të ndryshme.

192 furnitorë të ndërmarrjes kanë llogari të hapura te ndërmarrja për veprimtari komunale dhe 62 furnitorë kanë llogari të mbyllura me ndërmarrjen.

Fruktoret kryesisht e furnizojnë ndërmarrjen me:

- Inventar zyre (kompjutera personal – PC, printera, telefona, stilografa, letra etj)
- Sektori i ujësjellësit – gypa për ujësjellësin, pjesë për ujësjellësin, mekanizëm për ujësjellësin etj
- Mekanizimi – auto pjesë, naftë, karburante, vajra etj
- Higjiena – mjete për mirëmbajtjen e parqeve, motor sharre etj
- Teknologjia – mjet për pastrimin e kanalizimeve Kanal Jett

Furnitorët janë të vendeve dhe rajoneve të ndryshëm edhe atë:



Grafiku nr.1 Struktura e furnitorëve në bazë të vendndodhjes së tyre

Sipas grafikut nr. 1 shihet shumë qartë se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve furnitore të ndërmarrjes për veprimtari komunale janë nga Tetova (65%), Shkupi (17,6%), Gostivari (7,71%), Manstiri (1,43%), Velesi (0,39%), Ohri (0,39%), Koçani (1,17%), Gjevgjelia (0,39%), Prilepi (0,39%), Makedonski brodi (0,39%), etj.

Forca punuese


Rëndësia që ka në biznesin personeli si faktor prodhimi është i pamohueshëm.

Çdo biznes, që të jetë i përparuar kërkon të realizojë njëfarë përparësie ndaj konkurrentëve të tij.

Materialet, pajisjet, makineritë dhe sendet tjera që përdoren në biznesin e vogël mund të gjenden për të gjithë konkurrentët. Por marrëdhëniet e mira me punonjësit, domethënë me një grup punonjesh besnikë janë efikas nuk mund të blihen ose kopjohen nga konkurrentët. Poashtu ajo që ka rëndësi më tepër në biznes është që punëtorët të jenë sa më të motivuar dhe efikas në punë me qëllim që ndërmarrja të jetë sa më efikase në kryerjen e procesit të prodhimeve dhe shërbimeve.

Viti	Ujësjellës	Kanalizim	Higjiena	Transport	Shërbime të përbashkëta	Gjithsej
2012	59	20	113	27	110	329
2013	57	20	112	25	103	317
2014	57	18	115	27	107	324
2015	60	17	115	29	105	326
2016	61	17	117	31	105	331
2017	63	21	123	39	127	373
2018	65	27	140	43	133	408

Tabela nr.5 Numri i punëtorëve në bazë të sektorëve



Grafiku nr.2 Numri i punëtorëve sipas sektorëve

Rekrutimi dhe zgjedhja e personelit

